



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 269, datë 07.08.2020**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE**  
**LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E POSAÇME TË**  
**SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR**  
**POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 223, DATË 02.07.2020, TË**  
**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Për kandidatin e vetëm z. {...}, i cili ka kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedura e verifikimit të tij sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me Vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**